



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDRYSHE

21 prill 2016, Prizren

## KOMUNIKATË PËR MEDIA Publikohet Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

EC Ma Ndryshe ka publikuar Indeksin e Reformës së Transparencës Komunale, në kuadër të cilit janë pasqyruar rezultatet për 13 grupe indikatorësh relevantë që tregojnë nivelin e transparencës gjatë vitit 2015 në komunat e Prishtinës, Prizrenit, Ferizajit, Pejës, Gjilanit, Gjakovës dhe Mitrovicës.

Indeksi është lansuar gjatë konferencës, ku panelistët Ruairí O'Connell, ambasador i Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, Mimoza Kusari-Lila, kryetare e Komunës së Gjakovës, Gazmend Muhaxheri, kryetar i Komunës së Pejës dhe Jeta Xharra nga BIRN-i, kanë prezantuar pikëpamjet e tyre rreth transparencës, por edhe kanë marrë pjesë në diskutime me pjesëmarrësit, që kanë qenë përfaqësues të pushtetit lokal nga komuna të ndryshme, aktivistë të shoqërisë civile, gazetarë, etj.

Në Indeksin e Reformës së Transparencës Komunale figuron se Komuna e Gjakovës ka notë pozitive në 8 nga 13 indikatorët, me dy nota negative dhe tre neutrale. Në anën e kundërt qëndron komuna e Prizrenit, e cila ka 11 vlerësime negative dhe 2 neutrale. Mitrovica ka 7 nota neutrale e 6 negative. Ferizaj ka 6 nota neutrale dhe 7 negative. Edhe Peja ka 6 nota neutrale dhe 7 negative. Gjilani ka 5 nota neutrale dhe 8 negative. Pos Gjakovës, vetëm edhe Prishtina ka nota pozitive. Prishtina ka 3 nota pozitive, 6 neutrale dhe 4 negative.

Grupet e indikatorëve që janë monitoruar dhe mbi të cilat është shkruar Indeksi janë: Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit, Organizimi dhe funksionimi, Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse, Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve, Integrimi Evropian, Kontabiliteti dhe buxheti, Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve, Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike, Pasuria kapitale dhe jokapitale, Informimi dhe shërbimi i qytetarëve, Bashkëpunimi me shoqërinë civile, Planifikimi urban dhe Monitorimi i projekteve urbanistike. Përmbajtjen e plotë të Indeksit mund ta lexoni në vegzën: [http://ecmandryshe.org/repository/docs/160419223308\\_indeksi\\_alb.pdf](http://ecmandryshe.org/repository/docs/160419223308_indeksi_alb.pdf)

Në kuadër të diskutimeve, ambasadori O'Connell ka theksuar se “ka nevojë për ndryshim të mendësisë së qeverisjes, pra të ketë qasje të drejtë të zyrtarëve dhe llogaridhënie para qytetarëve”. “Mohimi i transparencës dhe llogaridhënies është fyerje e rëndë për qytetarët e një demokracie”, ka thënë O'Connell.

Kryetarja e Gjakovës, Mimoza Kusari – Lila, ka shtuar se ngritja e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies ka qenë njëri prej synimeve kryesore të qeverisjes lokale në Gjakovë dhe gjatë dy viteve të qeverisjes ka qenë njëri prej prioriteteve. Sipas saj synim i komunës së Gjakovës vazhdon të mbetet përmirësimi i mëtejshëm i nivelit të transparencës dhe llogaridhënies dhe raportet e tilla nga shoqëria civile janë një motivim shtesë për komunën e Gjakovës.

Kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri ka veçuar disa faktorë që ndikojnë në mos arritjen e standardeve të duhura të transparencës duke filluar nga kapacitetet e brendshme, por edhe rrethanat aktuale në vend.

Ndërkaq Jeta Xharra nga BIRN-i ka përkujtuar se ofrimi i dokumenteve dhe informatave nga zyrtarët pos që është obligim ligjor është edhe e drejtë e garantuar.

Projektin “Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale” EC Ma Ndryshe ka nisur që ta zbatoj nga maji i vitit 2015, falë përkrahjes së Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, i cili ka shtrirje në komunat e mëdha të Kosovës, Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj dhe Gjakovë, sikurse edhe në Suharekë, Rahovec, Malishevë, Dragash, Mamushë dhe Shtërpçë. Projekti në fjalë ka për qëllim që ti asistoj komunat në identifikimin e mangësive kryesore sa i përket transparencës sikurse edhe të ofroj udhëzime për adresimin dhe tejkalimin e tyre.

Me respekt,  
Elmedina Baxhaku, Monitoruese  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren  
Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy  
Pristina

*Projekti “Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale” përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*